



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 7 mars 2017

Numri i lëndës: 2015-06

X.C.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 mars 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar me 27 maj 2015.

2. Me 14 shkurt 2017, Paneli ka kërkuar nga ankuesi të ofroj informacione shtesë mbi statusin e procedurës penale, si dhe dokumente përkatëse.
3. Me 21 shkurt 2017, ankuesi ka ofruar dokumentet e kërkuara.

II. FAKTET

4. Faktet e lëndës siç janë paraqitur nga parashtruesi i ankesës mund të përmbliidhen si më poshtë:

Një padi ndaj tij e datës gusht 2014 ishte parashtruar në Gjykatën Themelore të Prishtinës nga prokurori special i EULEX-it. Ankuesi ishte akuzuar për bashkëkryerje të një veprë penale të grabitjes. Në kohën e parashtrimit fillestar të ankesës në Trupi Gjykues të përbërë nga dy gjykatës të EULEX-it dhe një gjykatës kosovar, gjykimi penal ndaj ankuesit ishte në vazhdim e sipër pranë kësaj gjykate.

5. Gjatë procedurave ankuesi ka njoftuar gjykatën rreth zbatueshmërisë së parimeve "*ne bis in idem*" dhe "*res judicata*" në rastin e tij. Gjykata ka njoftuar palët se çështja "*ne bis in idem*" do të adresohet në aktgjykim dhe në këtë mënyrë do të mund të apelohet.
6. Po ashtu, OJQ-ja "QKRMT" ka ngritur çështjen e zbatueshmërisë së parimeve "*ne bis in idem*" dhe "*res judicata*" në rastin e ankuesit përmes një letër drejtuar EULEX-it. Në përgjigje të kësaj kërkesë të datës 31 mars 2015, Zyra e shefit të Stafit të EULEX-it ka vënë në dukje se çështja ishte ende në shqyrtim gjyqësor.
7. Në aktgjykimin e tij të datës 7 gusht 2015, Gjykata Themelore e Prishtinës ka gjetur ankuesin fajtor ashtu siç ishte akuzuar. Në arsyetimin e tij, Gjykata Themelore ka diskutuar efektin e aktgjykimit të nxjerrë në Bahrein në procedurën penale ndaj ankuesit rreth zbatueshmërisë së parimit "*ne bis in idem*" në të dhe ka nxjerrë përfundimin se parimi nuk ishte i zbatueshëm në këtë rast.
8. Avokati i të pandehurit ka apeluar ndaj këtij aktgjykimi. Ai ka pohuar në këtë kontekst se neni 4 i KPPK-së, i cili ka përcaktuar parimin "*ne bis in idem*", ishin shkelur. Çështjet e mëposhtme po ashtu ishin ngritur edhe në Gjykatën Themelore:
 - Parimi "*ne bis in idem*" ishte parim universal dhe i vendosur gjatë i së drejtës ndërkombëtare. Si e tillë ai kishte një karakter absolut dhe për këtë arsye nuk mund të injorohet.

Gjithashtu neni 4 i KPPK-së, nenet 22.2 dhe 145.2 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe neni 4 i Protokollit nr. 7 Shtesë i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

njohin këtë parim. Më tej, neni 35.1 i Konventës Evropiane mbi Transferimin e Procedurave në Çështjet Penale iu është referuar në mënyrë të qartë parimit “*ne bis in idem*”. Kjo konventë ishte ratifikuar nga Jugosllavia dhe ishte e zbatueshme në Kosovë në bazë të rregullores së UNMIK-ut 1999/24. Prandaj ishte pohuar se parimi “*ne bis in idem*” duhej të zbatohet në Kosovë edhe në këtë rast të veçantë. Mbi këtë bazë, mbrojtja e ankuesit ka argumentuar se gjykimi i Gjykatës Themelore duhet të konsiderohet i pavlefshme për shkak se ka shkelur këtë parim.

- Ishte e paqartë nëse të dy aktgjykimet nga Bahreini që janë thënë se kanë shkaktuar zbatimin e parimit “*ne bis in idem*” ishin ende të vlefshme/të zbatueshme. Gjithashtu ishte e paqartë se cilat autoritete në Bahrein ishin të autorizuar për t’i shfuqizuar këto aktgjykime. Prandaj nuk ka pasur garanci se këto vendime nuk do të zbatoheshin. Prandaj mbrojtja e ankuesit ka sugjeruar që Gjykata Themelore nuk i kishte adresuar këto shqetësime në mënyrë të duhur. Prandaj ai ka pohuar se Gjykata e Apelit duhet t’i kushtoj vëmendje këtij parimi të rëndësishëm dhe të nxjerrë një vendim të pranueshëm.

9. Me 11 gusht 2016, Gjykata e Apelit në një trup gjykues në përbërje vetëm prej gjyqtarëve vendorë ka nxjerrë aktgjykimin. Gjykata ka lejuar ankesën dhe ka modifikuar këtë aktgjykim, por vetëm sa i përket dënimit. Në arsyetimin e vet, Gjykata e Apelit ka hedhur poshtë parashtrësit e ankuesit lidhur me zbatueshmërinë e parimit “*ne bis in idem*” në rastin e tij.

III. ANKESAT

10. Ankuesi pohon se ishte gjykuar, shpallur fajtor dhe dënuar me burgim të përjetshëm për të njëjtën veprë penale siç ishte gjetur më herët fajtor në Mbretërinë e Bahreinit.
11. Ankuesi më tej pohon se ka qenë i keqtrajtuar, përderisa ishte në paraburgim. Ai thotë se duart dhe këmbët i kishte të prangosura në mënyrë mizore, se ka qenë i vetëm në qelinë e tij për gati një vit, se asnjë trajtim mjekësor nuk i ishte ofruar atij dhe se nuk ishte bërë asnjë klasifikimi për të burgosurit (që do t’i lejonte atij të lirohej për fundjavë). Ai pohon se EULEX-i duhej ta kishte vizituar atë.
12. Ankuesi pohon se e drejta e tij për gjykim të drejtë (në veçanti parimet *ne bis in idem* dhe *res judicata*) dhe e drejta e tij që mos t’i nënshtrohej torturës dhe trajtimit poshtëruës janë shkelur.

IV. LIGJI

Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë

13. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
14. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
15. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e gjyqësisë, policisë dhe doganave.

Shkelja e supozuar e së drejtës për gjykim të drejtë

16. Paneli konstaton se ankesa e ankuesit ka të bëjë me procedurat penale në gjykatat e Kosovës.
17. Paneli ka konstatuar në mënyrë të përsëritur se në bazë të rregullës 25, paragrafi 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it Kosovë, nuk mund të shqyrtojë procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të gjykatës nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih *ndër të tjera, Fahri Rexhepi kundër EULEX-it*, nr. 2014-19, 10 nëntor 2014, par. 12; *Tomë Krasniqi kundër EULEX-it*, nr. 2014-04, 2 maj 2014, par. 14; *Gani Zeka kundër EULEX-it*, 2013-15, 4 shkurt 2014, par. 13).
18. Prandaj Paneli në parim nuk mund të shqyrtojë vendimet e gjykatave, ku si të tilla përbëhen edhe prej gjykatësve të EULEX-it. Megjithatë Paneli tashmë ka konstatuar se në rrethana të caktuara kompetencat e Panelit mbulojnë vendimet dhe aktet e autoriteteve gjyqësore si të tilla, në veçanti kur pohimet e besueshme lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut që i atribuohen gjykatëse të EULEX-it nuk janë adresuar plotësisht nga autoritetet gjyqësore kompetente në procedurat e apelit (*Milica Radunović kundër EULEX-it*, nr. 2014-02,

12 nëntor 2015 par 17; *Tomë Krasniqi kundër EULEX-it*, nr. 2014-04, 27 maj 2014, par 15).

19. Megjithatë në këtë rast Paneli thekson se aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës ka shqyrtuar zbatueshmërinë e parimit "*ne bis in idem*". Jo i bindur me arsyetimin e Gjykatës Themelore, ankuesi ka ngritur çështjet në ankesën e tij dhe Gjykata e Apelit ka shqyrtuar zbatueshmërinë e këtij parimi. Paneli thekson se argumentet e ankuesit ishin shqyrtuar nga Gjykata e Apelit, kështu që pretendimi i tij për shkelje të të drejtave të tij ishte adresuar plotësisht nga autoritetet kompetente gjyqësore.
20. Nga kjo del se kjo pjesë e ankesave nuk bie në kuadër të mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.

Keqtrajtimi i dyshuar gjatë paraburgimit

21. Paneli konstaton se nuk është argumentuar e lëre më treguar se EULEX-i ka qenë në ndonjë mënyrë i përfshirë në shkeljet e pretenduara të të drejtave të ankuesit, e as nuk sugjeron për mosveprim nga ana e tij.
22. Përderisa Paneli pranon se çështjet e ngritura nga ankuesi janë të një natyre serioze dhe duhet të konsiderohen me kujdes nga autoritetet kompetente, ato bien jashtë kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe OPLAN-it të EULEX Kosovë (shih *Dobrivoje Radovanović kundër EULEX-it*, nr. 2015-07, 27 qershor 2016, paragrafët 10-11; *Jovanka, Dragan dhe Milan Vuković kundër EULEX-it*, nr. 2013-18, 7 prill 2014, paragrafët 11-12).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 25 (1) të Rregullores së vet të Punës, dhe

SHBALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese